

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. M. nga Gjakova, për shkak të veprave penale vjedhje ne vazhdimësi nga neni 325/1-81 të KPRK-së, sipas Aktakuzave të Prokurorisë Publike në Gjakovë, PP-nr.1244/15 të dt. 23.05.2016, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë 24.08.2016, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla dhe te akuzuarit S. M., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. M.**, nga Gjakova, i biri i M. dhe i nënës H. e gjinisë L., i lindur me dt. ..., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, ashkali, shtetas i R. Kosovës, ne bashkëjetesë at i 1 fëmije.

I akuzuari S. M.:

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

I.

-me dt. 16.07.2015, ne Gjakovë rruga “S. Stavileci”, rreth orës 16:00, me qellim qe vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm, me qellim vjedhje, duke kaluar rrugës para një lokali përkatësisht interneti kur e vëren te parkuar e te pasiguruar një biçikletë, ngjyre e zezë, prone e te dëmtuarit A. (B.) H. nga Gjakova, rruga “...” nr. ..., e vjedh e me te largohet nga vendi, biçikletën e shet për 20 euro, afër st. te autobusëve ne Gjakovë, një personi te panjohur i cili po drejtonte një traktor, e te dëmtuarit i shkakton dem ne vlerë prej 90 euro.

II

-me dt. 27.07.2015 ne Gjakovë, rruga “UÇK”, rreth orës 12:00, me qellim qe vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm, me qellim vjedhje, duke kaluar rrugës pranë QT ”Viva Fresh” , kur e vëren nga pas te ngarkuar e te pasiguruar një biçikletë, ngjyrë e bardh, prone e te dëmtarit S. (M.) H. nga Gjakovë, rruga “...” ..., e vjedh e me te largohet nga vendi, e biçikletën e shet për 10 euro një personi te panjohur, e te dëmtuarit i shkakton dem material ne vlere prej 60 euro.

III

-me dt. 28.07.2015, respektivisht ne rrugën “H. Dobruna” rreth orës 19.00 me qellim qe vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm, me qellim vjedhje, duke kaluar rrugës e ne oborr te shtëpisë e vëren te parkuar e te pasiguruar një biçikletë, ngjyre vishnje, prone e te dëmtuarit L. (H.) K. nga Gjakova rruga “...” ..., e vjedhë e me te largohet nga vendi, e biçikletën e shet për 15 euro afër QT “ETC” ne Gjakovë, një personi te panjohur i cili po tregtonte pemë e perime, e te dëmtuarit i shkakton dem material ne vlere prej 80 euro.

IV

-me dt.09.08.2015, ne Gjakovë ne rrugën “UÇK “ rreth orës 17.30, me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasurore te kundërligjshëm, me qellim vjedhje duke kaluar rrugës, e kur para banesës e vëren te parkuar e te paçelesuar biçikletën ngjyre e kaltër, prone e te dëmtuarit B. (Sh.) K., nga Gjakova rruga “...”, e vjedhë e me te largohet nga vendi, e biçikletën e shet për 10 euro te blloku i ri një personi te panjohur i cili po tregtonte pemë e perime, e te dëmtuarit i shkakton dem ne lartësi prej 150 euro.

V

-me dt.23.08.2015, ne Gjakovë, ne rrugën “Tirana” rreth orës 18:00, me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm me qellim vjedhje duke kaluar rrugës e kur para banesës ne oborr te banesës e vëren te parkuar e te pasiguaruar një biçikletë me mbishkrimin “KONA”, ngjyrë e kaltër, prone te dëmtuarit A. (G.) R. nga Gjakova rruga “...” e vjedh e me te largohet nga vendi, e biçikletën e shet për 15 euro te mëhalla e Sefes një personi te panjohur, e te dëmtuarit i shkakton dem ne vlere prej 250 euro.

-me çka ka kryer veprat penale te vjedhjes ne vazhdimësi nga neni 325/1 lidhur me nenin 81 te KPRK-ës

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,7,17,41,45,73, 325/1-81 të KPRK-së, dhe nenit 365 te KPPK-ës te akuzuarit ia shqipton :

DËNIMIN ME BURG

Me dënim me burgim me kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë prej **300.00 (treqind) euro**, të cilat dënime do te ekzekutohen në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas neni 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti do t’i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet).-€**

Të dëmtuarit- A. H., S. H., L. K., B. K. dhe A. R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve procedurale dhe atë te paushallit gjyqësor e paguaj shumen prej **30 euro**, ne aftë prej **15 ditësh** pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP-nr.1244/15,dt.23.05.2016, kundër të akuzuarit S. M., për shkak se ka kryer veprat penale të vjedhjes nga neni 325/1-81 KPRK-ës, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publikë te mbajtur me të datë 24.08.2016, Prokurori Mone Sylja, lexon aktakuzat PP-nr.1244/15 dt.23.05.2016 deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës dhe deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit me qe pranimi i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme.

I akuzuari S. M., gjatë shqyrtimit fillestar me dt. 24.08.2016, lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se këto vepra i ka kryer për shkak te kushteve te renda ekonomike, me qene se jam i pa punë, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla, pendimi i shprehur ne gjykate si dhe gjendjen e varfër ekonomike.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari S. M., me date kohë dhe vend të cekura ne dispozitiv të këtij aktgjykimi ka kryer veprat penale të vjedhjes ne vazhdimësi nga neni 325/1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimit është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat që i përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata konstatoi se i njëjti është recidivist dhe është i njohur për vepra penale të natyrës së njëjtë sipas aktgjykimeve te kësaj gjykatë, i njëjti është ne vuajtje te dënimit me burgim dhe ndaj tij janë të ngritura disa aktakuza, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimitin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, pendimin e tij për veprat e kryera për shkak të gjendjes së varfër ekonomike-i pa punësuar dhe sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim. Kështu gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve** dhe dënimin me gjobë në shumë prej **300,00.-€**, me shprese dhe bindje se edhe me këtë dënim do ta arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera, shkallën e përgjegjësisë dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve te dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 të KPP-ës, pasi që gjykata gjate shqyrtimit fillestar nuk ka mundur te saktësojë lartësinë e demit që i akuzuari iu kanë shkaktuar te dëmtuarve pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e demit te shkaktuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 280/15 më datë 24.08.2016

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.